



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BULQIZË

PËR SISTEMIN E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE

(PAKETA FISKALE) 2021.

KAPITULLI I : TAKSAT VENDORE

L.1 TATIMI I THJESHTUAR MBI FITIMIN PER BIZNESIN E VOGEL

Çdo subjekt, i cili kryen një biznes, me anë të të cilit realizohet gjatë vitit fiskal qarkullim më i vogël ose i barabartë me 8 000 000 (tetë milionë) lekë, u nënshtrohet detyrimeve të parashikuara në këtë kre. Të ardhurat gjithsej nga veprimtaria e biznesit të vogël nënkuptojnë çdo lloj të ardhure, të realizuar gjatë periudhës tatimore dhe përfshijnë, pa u kufizuar vetëm në to: të ardhurat e realizuara nga furnizimi i mallrave dhe shërbimeve, të ardhurat nga pjesëmarrjet, të ardhurat nga interesat, të ardhurat nga shfrytëzimi i pasurisë së luajtshme e të paluajtshme.

Shkalla tatimore e aplikueshme mbi fitimin e tatueshëm për tatimpaguesit që i nënshtrohen tatimit të thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël, me qarkullim vjetor nga 0 (zero) deri në 8 (tetë) milionë lekë, është 0 (zero).

Çdo tatimpagues, subjekt i tatimit të thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël, është i detyruar që deri më 10 shkurt të vitit që pason periudhën tatimore të dorëzojë një deklaratë vjetore tatimore, ku të jepen hollësisht të ardhurat gjithsej, shpenzimet e zbritshme, fitimi i tatueshëm, si dhe çdo hollësi tjetër e përcaktuar me udhëzim të ministrit të Financave dhe Ekonomisë për plotësimin dhe dorëzimin e deklaratës tatimore vjetore.

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve nëpërmjet drejtorive rajonale tatimore është e ngarkuar me vlerësimin dhe kontrollin e tatimpaguesve, subjekt i tatimit të thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël. Administrata rajonale tatimore krijon një regjistër të veçantë mbi biznesin e vogël, në bazë të të dhënave që merr nga bashkitë. Ky regjistër do të përditësohet me hapjen e biznesve të reja.

L.2. TAKSA MBI PASURINË E PALUAJTSHME.

Në këtë zë përfshihen **Taksa mbi ndërtesën, Taksa mbi tokën bujqësore dhe Taksa mbi truallin.**

2.a) Taksa mbi ndërtesën

1. Taksës mbi ndërtesat i nënshtrohen individët, personat fizikë ose juridikë, vendës apo të huaj, pronarë ose përdorues të pasurive të paluajtshme në territorin e Republikës së Shqipërisë, pavarësisht nga niveli i shfrytëzimit të këtyre ndërtesave, përveç rasteve kur në këtë ligj

përcaktohen ndryshe.

2. Taksës mbi ndërtesat i nënshtrohen personat që kanë aplikuar për legalizim të ndërtesës, sipas ligjit “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”.

3. Taksës mbi ndërtesat i nënshtrohen zhvilluesit, të cilët nuk arrijnë të mbyllin ndërtimin sipas lejes përkatëse, të lëshuar nga autoriteti i planifikimit. Afati i përlllogaritjes së taksës fillon nga momenti i mbarimit të afatit kohor të përcaktuar në aktin e miratimit të kërkesës për leje ndërtimi.

4. Detyrimi për taksën mbi ndërtesat llogaritet si shumëzim i bazës së taksës me shkallën e taksës mbi ndërtesën. Detyrimin për pagimin e taksës mbi pasurinë e paluajtshme “ndërtesë” e kanë, sipas rastit, pronari ose bashkëpronari, sipas pjesës që zotëron, apo përdoruesi i pasurisë së paluajtshme, për pasuritë që nuk janë të pajisura me dokumente të pronësisë, personat që kanë aplikuar për legalizim të ndërtesës, zhvilluesit, të cilët nuk arrijnë të mbyllin ndërtimin sipas lejes përkatëse të lëshuar nga njësia e vetëqeverisjes vendore.

5. Taksa vendore mbi pasurinë e paluajtshme-ndërtesë llogaritet si detyrim vjetor i taksapaguesit. Pagesa e taksës bëhet çdo muaj apo për periudha më të gjata, në varësi të kategorisë së taksapaguesit, sipas përcaktimeve në vendimin e Këshillit Bashkiak .

Shkalla e taksës mbi ndërtesat, e cila aplikohet si përqindje e bazës së taksës, është si më poshtë:

- a) 0,05% për ndërtesën që përdoret, shfrytëzohet për banim;
- b) 0,2% për ndërtesën që përdoret, shfrytëzohet për veprimtari ekonomike;
- c) 30% e shkallës së taksës përkatëse për të gjithë sipërfaqen ndërtimore, për të cilën zhvilluesi është pajisur me leje ndërtimi dhe nuk ka arritur ta përfundojë atë sipas afatit të përcaktuar në aktin e miratimit të kërkesës për leje ndërtimi.

ç) çmimi për metër katror sipërfaqe ndërtimi për veprimtari tregtimi dhe shërbimi është 1.5 (një pikë pesë) herë më i lartë se çmimi i sipërfaqeve të banimit sipas qyteteve. Në këtë kategori do të përfshihen edhe ndërtesa tregtare, ku njëkohësisht realizohen edhe procese të përziera prodhim, tregtim ose/edhe shërbime me pakicë.

Çmimi për metër katror sipërfaqe ndërtimi të destinuara për banim në njësitë administrative jashtë qytetit përkatës, të cilat iu bashkuan njësitë të vetëqeverisjes vendore pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 115/2014, reduktohet deri në 35 (tridhjetë e pesë) për qind, krahasuar me çmimin e zonës më të afërt, përjashtuar zonat rezidenciale.

Çmimi i referencës për Bashkinë Bulqizë mbi bazene e të cilit do të behet përlllogaritja e taksës është **41.800** lek per m².

Kategoritë/Nënkategoritë e ndërtesës dhe qëllimi i përdorimit	Çmimi mesatar referues per banim	Çmimi mesatar referues per ndërtesa jo per banim
I. Ndërtesa për banim: a-ndërtuar para vitit 1993 b-ndërtuar gjatë dhe pas vitit 1993	70 % /çmimit të ref. 41.800 lek per m ²	
II. Ndërtesa për veprimtari ekonomike a- veprimtari tregtimi b- veprimtari industrial (magazine,fabrika,depo për prodhim dhe përpunim mallrave industrial) c-parkim i mbuluar/bodrome		1.5 herë/se çmimit të ref. 50% e çmimit të ref. 70% e çmimit të ref.

d-parkim i hapur, ndërtimi që përdoren për bujqësi dhe blegtori si: grumbullim, magazinim dhe ruajtje të produkteve bujqësore		30% e çmimit të ref.
---	--	----------------------

Mënyra e pagesës:

Detyrimi për taksën mbi ndërtesën është vjetor. Për kategoritë ` ndërtesa për veprimtari ekonomikë` biznes ky detyrim **paguhet me nje kest**. Afati i pagesës është data 30.06.2020 .Afati i pagesës për detyrimet e lindura pas datës 30.06.2021 është 30 ditë pas lindjes së detyrimit. . Për kategorinë ‘ndërtesa për banim’, detyrimi është vjetor dhe paguhet brenda vitit kalendarik.

Për familjarët që kanë kontratë me Ujësjetllës Sh.A. taksa e ndërtesës do të paguhet me 10 këste të barabarta, të përfshira në faturën e ujit të pijshëm. Kurse për familjarët që nuk kanë kontratë me Ujësjetllës Sh.A., taksa e ndërtesës do të paguhet me një kësht të vetëm, në të njëjtën kohë me Tarifën e Shërbimit Publik dhe Taksën e Tokës Bujqësore për familjet që banojnë në fshat. Çdo posedues pasurie duhet të paraqesë dokumentin e pronesisë mbi pasurinë që zotëron, në të kundërt pagesa do llogaritet duke marrë për bazë sipërfaqen prej 70 m2 për ndërtesat para vitit 1993 dhe pas këtij viti ,100 m2 (prezymbimi i sipërfaqes) për çdo rast. Ne rolin e agjentit tatimor, Ujësjetllës Sh.A. do të marrë një komision, i cili përcaktohet me marrëveshje të veçantë ndërmjet dy institucioneve përkatëse.

Përjashtime nga pagesa e taksës:

- a) pronat e shtetit dhe të njëjstive të qeverisjes vendore, që përdoren për qëllime jofitimprurëse;
- b) pasuritë në pronësi të shtetit, të kaluara me vendim të Këshillit të Ministrave, nën administrimin e shoqërive publike shtetërore;
- c) ndërtesat e banimit, që shfrytëzohen nga qiramarrësi me qira të paliberalizuara;
- ç) banesat sociale në pronësi të bashkive;
- d) pasuritë e paluajtshme-ndërtesa, pronë e subjekteve juridike ose fizike, që në bazë të marrëveshjeve me bashkitë përdoren nga këto të fundit si banesa sociale;
- dh) ndërtesat që përdoren nga komunitetet fetare, në funksion të veprimtarisë së tyre;
- e) strukturat akomoduese “Hotel/Resort me katër dhe pesë yje, status special”, sipas përcaktimit në legjislacionin e fushës së turizmit dhe që janë mbajtës të një marke tregtare të regjistruar dhe njohur ndërkombëtarisht “brand name”;
- “ë) ndërtesat e banimit, të deklaruara si vendbanim nga kryefamiljarët që përfitojnë vetëm pension pleqërie/pension social, kur familja e tyre përbëhet vetëm nga pensionistë, ose dhe me persona në ngarkim të tyre, që janë të paafte për punë;”.
- f) ndërtesat e banimit të kryefamiljarëve që trajtohen me ndihmë ekonomike;
- g) ndërtesat kulturore, nën mbrojtje të përkohshme ose të përhershme, për kohën në të cilën deklarohet mbrojtja, sipas legjislacionit në fuqi për monumentet e kulturës dhe/ose trashëgiminë kulturore, të cilat përdoren vetëm për qëllime jofitimprurëse”.

Për të përfituar nga përjashtimi, këto familje duhet të dorëzojnë në drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore të Bashkisë dokumentat e mëposhtëm

- Librezën përkatëse;
- Vërtetimin e përfitimit të ndihmës ekonomike.

Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës mbi ndërtesat për biznesin e të gjitha kategorive është Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore pranë Bashkisë Bulqize.

Për vjeljen e taksës së ndërtesës për qëllime banimi, ngarkohet Ujësjetllës SH.A. Bulqize për vjeljen e taksës së ndërtesës për familjarët që kanë kontratë me Ujësjetllësin.

Për familjet që nuk kanë kontratë me Ujësjellës Sh.A.struktura përgjegjëse për vjeljen e kësaj takse është Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore pranë Bashkisë Bulqize,në bashkëpunim me njësitë administrative përkatëse.

2.b) Taksa mbi tokën bujqësore.

Taksa mbi tokën bujqësore është detyrim vjetor dhe paguhet me një këst brenda vitit fiskal. Baza e taksës mbi tokën bujqësore është sipërfaqja e tokës në hektarë, në pronësi të taksapaguesit. Niveli i taksës caktohet në lekë për hektar. Detyrimi i taksës llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës me bazën e tatueshme. Sipërfaqja e tokës në pronësi përcaktohet sipas dokumentave që e vërtetojnë atë. Kategoritë minimale të bazës së taksës dhe nivelet treguese të taksës për çdo kategori janë si vijon:

Klasifikimi sipas kategorisë së tokës bujqësore	Vlera e taksës në lekë/hektar/vit
I	1 400
II	1 200
III	1 100
IV	1 000
V	9 00
VI	8 00
VII-X	7 00

Në rast të mungesës së dokumentacionit të pronësisë, përdoruesi i tokës bujqësore bën një vetëdeklarim të sipërfaqes së tokës bujqësore, pranë bashkisë ku ndodhet toka. Pas vetëdeklarimit ,Drejtoria e të Ardhurave mund të bëjë verifikimin në lidhje me saktësinë e këtij deklarimi dhe në raste të konstatimit të deklarimit të ndryshëm me realitetin pagesa do përlllogaritet për të gjithë periudhën.

Mënyra e pagesës:

Detyrimi për taksën mbi Token Bujqesore është vjetor. Për të gjitha kategoritë ky detyrim **paguhet me një këst**. Afati i pagesës është data 31.10.2021 .Afati i pagesës për detyrimet e lindura pas datës 31.10.2021 është 30 ditë pas lindjes së detyrimit. Cdo posedues pasurie duhet të paraqesë dokumentin e pronesisë mbi pasurinë që zotëron.

Për pronat e njohura nga komisioni i kthimit pronave sqarojmë se: për personat që i zoterojnë këto prona aplikohet taksa sipas natyrës së pronës, nëse është tokë bujqësore, trajtohen si të tilla nëse janë pyje ose inproduktive sipas ligjeve në fuqi.

Sipërfaqja e tokës përcaktohet mbi bazën e dokumentave të pronësisë, **formulari 6, akti I** pronësisë,certifikatë e regjistrimit të tokës.

Përjashtime:

Përjashtohen nga taksa e tokës bujqësore, vetëm për normën individuale të tokës, individët:

- Tokat bujqësore, që mbillen me kultura drufrutore dhe vreshtari për pesë vitet e para nga çasti i mbjelljes.

Struktura përgjegjëse për vlerësimin dhe mbledhjen e taksës do të jetë Drejtoria e Bujqësisë,Drejtoria e të Ardhurave dhe Pronave,Njësitë Administrative respektive.

Ngarkohet Drejtoria e Bujqësisë, për vlerësimin e kategorisë së tokës si dhe saktësimin dhe

verifikimin e periudhës së mbjelljes me kultura drufrutore dhe vreshtari, për çdo fermer/fermë.

2.c) Taksa mbi truallin.

Baza e taksës mbi truallin është sipërfaqja e truallit, në metër katror, në pronësi apo përdorim të taksapaguesit, është detyrim vjetor dhe paguhet brenda datës 30 qershor të vitit fiskal. Sipërfaqja e truallit në pronësi përcaktohet sipas dokumenteve që e vërtetojnë atë. Në rast të mungesës së dokumentacionit të pronësisë, përdoruesi i truallit bën një vetëdeklarim të sipërfaqes së truallit në përdorim, pranë bashkisë ku ndodhet trualli. Pas vetëdeklarimit Drejtoria e të Ardhurave mund të bëjë verifikimin në lidhje me saktësinë e këtij deklarimi dhe në raste të konstatimit të deklarimit të ndryshëm me realitetin pagesa do përlllogaritet për të gjithë periudhën. Për çdo kategori minimale të truallit, këshilli bashkiak mund të miratojë nënkategorizime. Niveli i taksës caktohet në lekë për metër katror. Detyrimi i taksës llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës me bazën e tatueshme. Taksa e mbledhur, në mbështetje të këtij ligji, paguhet në buxhetin e bashkisë, në territorin e së cilës ndodhet prona e taksueshme.

Kategoritë minimale të bazës së taksës dhe nivelet treguese të taksës për çdo kategori minimale të bazës për taksën mbi truallin është si vijon:

Klasifikimi sipas bashkive	Vlera e taksës në lekë/m2/vit për qëllime banimi nga individët	Vlera e taksës në lekë/m2/vit për qëllime biznesi
Bashkia Bulqizë	0,14 lekë/m2	12 lekë/m2

Struktura përgjegjëse për vlerësimin dhe mbledhjen e taksës do të jetë Drejtoria e të ardhurave, Njësitë Administrative dhe për kategorinë Individë Ujësjetës SH.A (Për Ato Njësi ku ofron shërbimin).

Mënyra e pagesës:

Detyrimi për taksën mbi truallin është vjetor. Për kategorinë biznes ky detyrim **paguhet me një këst**. Afati i pagesës është data 30.06.2021. Afati i pagesës për detyrimet e lindura pas datës 30.06.2021 është 30 ditë pas lindjes së detyrimit. Cdo posedues pasurie duhet të paraqesë dokumentin e pronësisë mbi pasurinë që zotëron.

I.3 TAKSA E FJETJES NË HOTEL.

Baza e taksës së fjetjes në hotel, është çmimi i fjetjes, për dhomë ose për person, për një natë me koeficient shtrytëzimi 250 ditë në vit. Janë subjekt i taksës të gjithë hotelet, motelet, stabilimentet turistik, shtëpitë e pritjes, turizëm familjar dhe çdo objekt tjetër që përdoret për këtë ushtrim veprimtarie.

Detyrimi për taksën llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës së vendosur nga bashkia, për natë qëndrimi, me numrin e netëve të qëndrimit në hotel.”.

Niveli i taksës do të jetë 35 lekë për natë qëndrimi në bujtinë, fjetinë, motel dhe cdo njësi tjetër akomoduese sipas përcaktimeve të ligjeve për turizmin dhe 105 lekë për natë fjetje për Hotele

me 4-5 Yje.

Mënyra e pagesës:

Pagesa kryhet brënda datës 5 të muajit pasardhës. Detyrimi për taksën i takon klientit që strehohet në hotel, detyrim i cili mbahet nga hoteli për llogari të Bashkisë dhe evidentohet në faturën e hotelit ku shënohet cmimi i fjetjes dhe vlera e taksës.

Struktura përgjegjëse për vlerësimin dhe mbledhjen e taksës do të jetë Drejtoria e të Ardhurave.

I.4 TAKSA E NDIKIMIT NË INFRASTRUKTURË NGA NDËRTIMET E REJA.

4.1 Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja.

Niveli i taksës sipas kategorive dhe nënkategorive për klasifikimin e investimeve të përcaktuara sipas zonave kadastrale, është si në tabelën më poshtë:

A. Zona Kadastrale **3694**, me zhvillim rural **dhe**

B. Zonat Kadastrale **8611** dhe **8612** me zhvillim urban.

ZONAT	Kategoritë dhe nënkategoritë e përdorimit	Tarifa në %
A	Objekte banimi	2%
	Objekte sociale, ekonomike, objekte administrative, shërbimi, etj një kateshe	2.7%
	Objekte sociale, ekonomike, objekte administrative, shërbimi, etj mbi një kat e parkim nën tokë.	2.3%
	Investime me financime të huaja në shërbime infrastrukture, shkolla, cerdhe, kopshte etj	1%

ZONAT	Kategoritë dhe nënkategoritë e përdorimit	Tarifa në %
	Objekte banimi	2%
	Objekte sociale, ekonomike, objekte administrative, shërbimi, etj një katëshe	3%
B	Objekte sociale, ekonomike, objekte administrative, shërbimi, etj mbi një kat e parkim nën tokë.	2.7%
	Investime me financime të huaja në shërbime infrastrukturë,	1%

shkolla, cerdhe , kopshte etj	
-------------------------------	--

4.1.1 NJËSIA ADMINISTRATIVE MARTANESH, ZERQAN, FUSHË-BULQIZE, SHUPENZE, GJORICË, OSTREN DHE TREBISHT

“Taksa e ndikimit ne infrastrukturë nga ndërtimet e reja për dhënien e lejes së ndërtimit”, I shtohet tabela me përmbajtjen si mëposhte:

ZONAT	Kategoritë dhe nënkategorite e përdorimit	Tarifa ne %
	Objekte banimi	1%
	Objekte sociale, ekonomike, objekte administrative, shërbimi, etj një katëshe	2%
	Objekte sociale, ekonomike, objekte administrative, shërbimi , etj mbi një kat e parkim nën tokë.	1.5%
	Investime me financime te huaja në shërbime infrastrukturë, shkolla, cerdhe , kopshte etj	1%

1. Mënyra e pagesës:

a) Përlllogaritja e detyrimit nga taksa do të bëhet, duke aplikuar përqindjet përkatëse sipas kategorisë dhe nënkategorisë, ndaj vlerës së investimit dhe për sipërfaqe respektive.

Në rastet kur një ndërtueseëka funksione të perziera (banim dhe administrative etj, përlllogaritja e detyrimit nga taksa do të bëhet, duke aplikuar përqindjet përkatëse sipas kategorisë dhe nënkategorisë, ndaj vlerës së investimit për sipërfaqet respektive të pjesës së banimit dhe atë administrative, shërbimit etj.

“Taksa paguhet Brenda 5 ditëve nga data e marrjes së vendimit për miratimin e lejes për punime dhe lëshimit të autorizimit të pagesës nga Drejtoria e Planifikimit të Territorit. Në rast se kerkuesi nuk kryen pagesën Brenda 5 ditëve pune nga njoftimi për detyrimin ndaj shtetit, sipas ligjit, Kryetari i Bashkisë vendos masa te tjera te përshtatshme,deri në refuzimin e lejes ”.

2. Lehtësira Tatimore

a) Përjashtimisht për objektet e infrastrukturës, për ndertimin e rrugëve kombëtare, te porteve, aeroporteve, tuneleve, digave, ndërtimit të infrastrukturës në energji, përfshi makineritë dhe paisjet për keto projekte, taksa e ndikimit në infrastrukturë të ndërtimeve te reja është 0.1% e vlerës së investimit, por jo më pak se kostoja e rehabilitimit te infrastrukturës së dëmtuar.

- b) Për ndërtesat të cilat janë në proces legalizimi, taksa e ndikimit në infrastrukturë e ndërtimeve të reja është 0.5% e vlerës së investimit.
- c) Në rastin e ndërtimeve për qëllime banimi apo njësi shërbimi nga shoqëritë e ndërtimit, të cilat nuk destinohen për përdorim në sektorin e turizmit, industrisë apo përdorim publik, taksa e ndikimit në infrastrukturë është në masën 4 për qind deri 8 për qind të çmimit të shitjes për metër katror.

Strukturat e ngarkuara për vlerësimin dhe vjeljen e taksës është Drejtoria e Planifikimit të Territorit dhe Drejtoria e të Ardhurave dhe Pronave.

I.5 TAKSA MBI KALIMIN E SË DREJTËS SË PRONËSISË PËR PASURITË E PALUAJTSHME

1. Taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme vendoset për ndërtesat dhe të gjitha pasuritë e paluajtshme në çastin e kalimit të së drejtës së pronësisë mbi to. Taksa paguhet nga personi, që kalon të drejtën e pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme, para kryerjes së regjistrimit, në përputhje me aktet ligjore në fuqi.

2. Baza e taksës mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për ndërtesat është sipërfaqja e ndërtimit, pronësia e së cilës transferohet. Kategoritë e ndërtesave, për efekt të bazës së taksueshme, jepen në tabelën e mëposhtme. Niveli i taksës caktohet në lekë për metër katror të bazës së taksës. Detyrimi tatimor llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës me bazën e tij..

Niveli i taksës do të jete sipas tabelës së mëposhtme:

KATEGORITË	NIVELI LEK/M2
I. Ndërtesa banimi	100 lek/m ²
II. Ndërtesat e tjera për tregti dhe shërbime	300 lek/m ²
III. Ndërtesa të tjera	200 lek/m ²

3. Baza e taksës për kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e tjera të paluajtshme është vlera e shitjes së tyre. Niveli i taksës caktohet në përqindje dhe niveli tregues i taksës është 2 për qind. Detyrimi tatimor llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës me bazën e tij.

4. Vjelja e kësaj takse bëhet nga zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, të cilat, në rolin e agjentit të taksave, përfitojnë 3 për qind të shumës së arkëtuar dhe diferencën e derdhit për llogari të buxhetit përkatës të bashkisë ose të , në territorin e së cilës ndodhet pasuria, jo më vonë se data 30 e muajit pasardhës.

Përjashtimet.

1. Përjashtohen nga pagimi i taksës mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme:

a) Enti Kombëtar i Banesave, Ministria e Financave dhe organet e qeverisjes qendrore e vendore;

b) personat, të cilët janë subjekt i tatimit mbi të ardhurat vetjake, në mbështetje të ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”;

c) subjektet që dhurojnë pasuri të paluajtshme kur përfitues të drejtpërdrejtë janë:

i. institucionet dhe entet shtetërore e publike, qendrore e vendore;

ii) bashkësitë fetare ose organizatat jofitimprurëse, kur dhurimi lidhet me atë pjesë të

veprimtarisë së tyre pa qëllim fitimi. Në këto raste dhuruesi, pasi ka marrë vërtetimin nga këshilli

bashkiak ose l për përjashtimin nga taksa, bën regjistrimin e pasurisë së paluajtshme të dhuruar. Në çastin e regjistrimit, dhuruesi paguan pjesën që i takon agjentit të taksave.

2. Në rastet kur pranohet nga vetë palët ose kur vërtetohet ligjërisht simulim i dhurimit për llogari të një shitjeje, për shmangie nga taksa, zbatohen taksa sa dyfishi i vlerës, pavarësisht nga përgjegjësitë e tjera sipas ligjeve në fuqi.

I.6 TAKSA VJETORE E MJETEVE TË PËRDORURA.

Drejtoria Rajonale të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor (DRSHTRR), të cilat janë agjent tatimor të mbledhjes së taksës vjetore të mjeteve të përdorura, mbledhin këtë taksë dhe e derdhin, brenda datës 30 të çdo muaji, për llogari të organeve tatimore të administratës qendrore dhe njësisive të qeverisjes vendore. Drejtoria rajonale e shërbimeve të transportit rrugor i ndan të ardhurat nga taksa e mjeteve të përdorura sipas njësisive të qeverisjes vendore, mbështetur në vendbanimin e taksapaguesit që zotëron mjetin e transportit. Nga shuma e përgjithshme e të ardhurave mujore të arkëtuara nga taksa vjetore e mjeteve të përdorura, drejtoria rajonale të DRSHTRR-së, pasi mbajnë komisionin prej 5 (pesë)% të totalit mujor të të ardhurave, derdhin me anë të faturës për arkëtim, 25 (Njeze e pese)% të këtyre të ardhurave në llogarinë bankare të degës së thesarit të rrethit, ku është njësia e qeverisjes vendore. Rakordimi i pagesës së taksës ndërmjet strukturave të DRSHTRR-së me organet tatimore të administratës qendrore dhe vendore kryhet në bazë të regjistrimit ditor të taksës vjetore të mjeteve të përdorura, formati i të cilit është i përcaktuar me udhëzim të Ministrit të Financave.

Struktura e ngarkuar për vjeljen e kësaj takse është Drejtoria Rajonale e Shërbimeve të Transportit Rrugor.

I.7. TË ARDHURA PJESORE NGA TAKSA E RENTËS MINERARE.

Baza e taksës: Janë burimet natyrore që nxjerr nga nëntoka çdo person fizik apo juridik, në çastin kur ai shet produktin. Çdo person fizik apo juridik, që është i liçencuar dhe/ose vepron në industrinë minerare, sipas një marrëdhënieje kontraktuale me ministrin përgjegjës për ekonominë, duhet të paguajë rentë minerare për burimet natyrore që nxjerr nga nëntoka. Renta minerare llogaritet si detyrim mujor i subjektit taksapagues, në çastin kur ai shet produkte minerare.

Strukturat përgjegjëse për vjeljen e taksës:

Struktura e mbledhjes e kësaj takse është Drejtoria e Përgjithshme e Doganave/Tatimeve. Degët e doganave në rrethe ngarkohen për arkëtimin e kësaj rente, në rastin e eksportit të produkteve minerare, ndërsa degët e tatimeve ngarkohen për arkëtimin e kësaj rente, në rastin e shitjes së produkteve minerare brenda vendit, (5%) e të ardhurave të realizuara nga kjo taksë i kalon përkatësisht Bashkisë Bulqizë në llogarinë e degës së thesarit.

I.8 TË ARDHURANGA TATIMI MBI TË ARDHURAT PERSONALE .

Tatimi mbi të ardhurat personale, llogaritet mbi të ardhurat e individëve. Njësitë e vetëqeverisjes vendore përfitojnë si taksë të ndarë, 2 (dy) për qind e të ardhurave nga tatimi mbi të ardhurat personale.

I.9 TAKSA E TABELËS.

Kjo taksë aplikohet për të gjitha subjektet fizike, juridike, private e shtetërore, vendas apo të huaj që kryejnë veprimtarinë e tyre brenda territorit të Bashkisë Bulqizë. Niveli i kësaj takse për Bashkinë Bulqizë është sipas Aneksit 7 te ligjit Nr. 106/2017 :

Detyrimi për taksën e tabelës është vjetor. Për të gjitha kategoritë ky detyrim **paguhet me nje këst**. Afati i pagesës është data 30.06.2021 .Afati i pagesës për detyrimet e lindura pas datës 30.06.2021 është 30 ditë pas lindjes së detyrimit. .

Struktura përgjegjëse për vlerësimin dhe vjeljen e taksës do të jetë Drejtoria e të Ardhurave dhe zyrat në Njesitë Administrative.

I.9 DHËNIE E LIÇENCAVE PËR TREGËTIMIN E NAFTËS BRUTO DHE NËN PRODUKTEVE TË SAJ

Bashkia Bulqizë jep liçence për personat juridikë të cilët ushtrojnë veprimtarinë e tyre për tregëtimin e karburanteve për automjete (stacionet e shitjes së karburanteve) dhe për shitjen e lëndëve djegëse (njësitë e shitjes së lëndëve djegëse) në territorin e Bashkisë Bulqizë sipas VKM nr.970 date 02.12.2015 dhe VKM nr. 344,date 19.04.2017.

Tarifa për autorizim shitje karburanti.

1 Liçence per njesite e shitjes se lendes djegese, qe ushtrojne veprimtarine e tyre per perdorin nga konsumatorët fundore. Lekë/license 100,000 .

2 Licensë për stacionet e shitjes te karburanteve me pakicë(të naftës,benzinës dhe nënprofukteve të tyre) për 5 vjet .Lekë/Licensë 1,000,000.

KAPITULLI II: TARIFAT VENDORE

Ky kapitull trajton tarifatat vendore në mënyrë nominale duke u nisur nga elementët:

- Llojit të shërbimit, baza e taksueshme, kategorizimet dhe nënkategorizimet, këstet e pagimit, koha e kryerjes së tyre, kushtet lehtësuese, strukturat përgjegjës për vjeljen e detyrimeve dhe agjentët tatimorë.

II.1.1 Tarifa e Pastrimit dhe largimit te mbeturinave.

Përkufizimi: Tarifës së pastrimit i nënshtrohen të gjithë familjet, personat fizikë ose juridikë, vendas ose të huaj, që banojnë/janë rezidentë dhe ushtrojnë veprimtari ekonomike brenda territorit të Bashkisë Bulqizë dhe njësisive të saj administrative.

Niveli i tarifës së pastrimit: Kategoritë, nënkategoritë dhe nivelet treguese janë të shprehura si më poshtë:

- Niveli i tarifës së pastrimit dhe largimit te mbeturinave për familjet do të jetë sipas tabelës së mëposhtme:**

Tab 1.

	KATEGORITË	
	FAMILJARET (PËR FAMILJE)	LEKË NË VIT

	Njësia Administrative Bulqizë	1400
	Njësia Administrative Fushë Bulqizë	800
	Njësia Administrative Gjoricë	700
	Njësia Administrative Krastë	900
	Njësia Administrative Ostren	600
	Njësia Administrative Shupenzë	900
	Njësia Administrative Trebisht	200
	Njësia Administrative Zerqan	700

b. Tarifë pastrimi për institucione.

Niveli i tarifës së pastrimit dhe largimit të mbeturinave për Institucionet do jetë sipas tabelës së mëposhtme:

NR	SUBJEKTI	Tab 2. VLERA E TARIFËS
1	Bankat	200,000
2	OSSH SH.A	115,000
3	Telekomi	115,000
4	FSHU SH.A	115,000
5	Posta Shqiptare	50,000
6	Dega e Thesarit	50,000
7	Drejtoria e Shëndetit Publik	50,000
8	Sigurimet Shoqërore	50,000
9	Komisariati i Policisë	50,000
10	Agjencia Rajonale e Ekstensionit Buqësor	50,000
11	Zyra e Arsimit	50,000
12	Dega e Tatim - Taksave	50,000
13	Nënprefektura	50,000

14	Zyra vendore e regjistrimit të pasurive te paluajtshme	50,000
15	Zyra vendore e punësimit	50,000
16	Spitali	100,000

c.Tarifa e pastrimit dhe largimit të mbeturinave për bizneset.

Niveli i tarifës së pastrimit për bizneset në Njësinë Administrative Bulqizë do të jetë si në tabelat e mëposhtme:

Tab 3.

Kategoritë e subjekteve	Biznes i vogël Lekë/vit	Biznes i madh Lekë/vit
Njësi tregtimi		
Mish, Peshk	7000	35000
Bulmet, fruta, perime, ushqimore dhe artikuj të tjerë të ngjashëm me to	9000	37000
Artikuj industrialë (veshje,këpucë , parfumeri,argjendari, etj. të ngjashme me to).	6000	27000
Rroba e kepuce etj,te ngjashme me to, te perdorura.	4000	30000
Material ndertimi,elektrike, hidraulike	10000	32000
Bar kafe	7000	32000
Restorant	14000	40000
Fast- Food	7000	30000
Piceri	9000	30000
Gjellëtore	9000	30000
Pub, diskoteka etj. të ngjashme.	9000	32000
Artikuj te ndryshem etj .	7000	32000
Njësi tregtimi lëndësh djegëse, hidrokarbure, Karburante etj. te ngjashme me to.	14000	40000
Shitje produktesh farmaceutik edhe të ngjashme me to.	15000	35000
Ambulantë	4000	4000
Farmaci Bujqesore, Sherbim Veterinar,Prodhim/shitje fidanash .	7000	32000
Lokalet e dasmave	14000	32000
Veshje popullore	4000	10000
SHITJE ME SHUMICË		
Magazina, dyqane, etj. te cilat realizojnë shitje me shumicë.	14000	37000
NJËSI PRODHIMI		
Përpunim duralumini, metalesh, druri,tapicerie, letre, kartoni, plasmasi etj. te ngjashme me to.	10000	47000
Punime teneqepunues,të ngjashme me to	5000	10000
Prodhim tulla, tjegulla, blloqe betoni, furra gelqereje etj.	9000	47000

	te ngjashme me to.		
	Prodhime ushqimore, buke, ëmbëlsirash, bulmeti, pijesh etj. te ngjashme me to.	9000	32000
	Perpunim mish, peshk etj. te ngjashme me to.	9000	37000
	Rritje peshku	20.000	35000
	Prodhim konfeksione, etj. te ngjashme me to.	9000	47000
	Prodhim, përpunim vajrash, naftë , gazi e nenprodukte Etj. te ngjashme me to.	9000	47000
	Impiante, territore per therrjen e kafshëve etj. te ngjashme me to.	24000	57000
	Shtypshkronja etj. te ngjashme me to.	14000	47000
	Impiante, linja për prodhim dhe përpunim e produkteve ushqimore ose të tjera.	9000	42000
	Prodhim perpunim produkte farmaceutike etj. te ngjashme me to.	15000	42000
	SUBJEKTE NDËRTIMI		
	Njësi ndërtimi për çdo kantier ndërtimi, objekte banimi, shërbimi, të përbëra etj. të ngjashme me to.	20000	100000
	Rikonstruksione te pjesëshme	10000	60000
	Shfrytëzimi i inerteve dhe gurorëve	20000	350000
	NJËSI SHËRBIMI		
	Riparimi i artikujve telefona celulare, elektro-shtëpiake, radio televizorë, frigorifere, lavatriçe, manjetofon, paisje fonie e të tjera të ngjashme me to	7000	32000
	Institucione financiare: agjensi transferim parash, Shërbime agjensi kembimi valute, agjensi turizmi, të ngjashme me to.	10000	110000
	Agjenci Sigurimesh e te ngjashme me to .	8000	30000
	Kurse për kompjuter e për parukeri, agjensi doganore, shërbimet për konviktet, pikat e shërbimit parkimi i makinave, agjenci transporti, lanvanteritë, pastrimi kimik, sallat e lojrave të ndryshme (gjimnastikë, aerobie, cirqe, kende lojrash per femije, ping pong, bilardo etj.) e të tjera shërbime të ngjashme me shërbimet e lartë përmendura.	5000	42000
	Autoshkollë , shërbime të rojeve civile	10000	40000
	Kancelari ,Studio fotografie, biblioteka	5000	42000
	Autoservis (mekanik, xhenerik, elektroauto, lyerje, gomisteri etj)	10000	40000
	Hotele, motele (lekë/ dhomë në vit).	500	800
	Njësi shërbimi marangoz, rrobaqepës, këpucar, berber, orëndreqës etj.	5000	42000
	Komplekse sportive, palestra, fitnes, pishina, qendra e institute kërkimore-shkencore, salla koncerte-mbledhje e videoteka.	10000	37000
	Sallon Bukurie ,Parukeri etj, të ngjashme me to	10000	30000
	Lojra me kompjuter, lojra fëmijësh të hapura dhe të mbyllura Njësi të tjera (që nuk përfshihen në kategoritë dhe nënkategoritë si më lart).	5000	42000
	Fushe minifutbolli (Kalçeto)	15000	40000

	Lavazhe	6000	30000
	Kompanite Celulare	15000	40000
	Antena kabllore dhe televizive	40000	60000
	Pjese Kembimi per automjete .	10000	40000
	SHOQATA, FONDACIONE, ORGANIZATA JOQEVERITARE JOFITIMPRURESE	0	0
	PROFESIONE TE LIRA		
	Mjeket, mjeku-laborant, stomatologu, ekonomisti kontabël të miratuar, eksperti kontabël të autorizuar, mësuesit, veterinerët, agronomit, botuesit, inxhinier, arkitekti, projektuesi, e te tjera profesione te lira te cilat ushtrohen në njësi fikse apo në ambiente të ndryshme e të tjerë të ngjashëm me to.	8000	30000
	Avokatët, noter	20000	30000
	Galeritë e artit të piktorëve, skulptorëve dhe artistëve të tjerë qe prodhojnë dhe tregtojnë objekte artistike	15000	35000
	Institucionet jopublike te edukimit (shkollat, kopshtet apo çerdhet), ,shërbimet ne klinikat e specialiteteve te ndryshme mjekësore, shërbimet në laboratorë diagnostifikimi.	7000	17000
	Nxjerrja, Prodhimi dhe përpunimi i mineraleve. HEC-		
	Subjektet Minerare te regjistruara në DRT perveç Drejtorisë Rajonale te tatimpaguesve të Mëdhenj	200 000 lekë/ për cdo leje subjekte te regjistruara në DRT	
	Hydrocentrale (Per cdo vendndodhje) 1 .Hec-e që janë në prodhim energjie - me fuqi instaluese deri në 1 më -me fuqi instaluese nga 1 deri 3 më -me fuqi istaluese mbi 3 më	150.000 lek 250,000 lek 300,000 lek	
	Subjekte Minerare të regjistruara në Drejtorinë Rajonale te Tatimpaguesve të Mëdhenj	2 000 000 lekë	

II.1.2. Tarifa e ndriçimit

Përkufizimi: Tarifa e ndriçimit paguhet nga bizneset vendas , personat fizikë ose juridikë, që banojnë/janë rezidentë brenda territorit të Bashkisë Bulqize.

Kategoritë, nënkategoritë dhe nivelet treguese të Tarifës së ndriçimit janë të shprehura si më poshtë:

a. Tarifë ndriçimi për familjet

Niveli i tarifës së ndriçimit për familjet do të jetë si në tabelën e mëposhtme:

NR	KATEGORITË	
	FAMILJARET (PËR FAMILJE)	LEKË NË

		VIT
